



ANEX 1. INFRASTRUKTURA. UDHËZIME-PËRKUFIZIME.

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave të krijimit të AKTI-it, një nga programet dhe detyrat e rëndësishme të agjencisë është edhe Programi i Infrastrukturës.

1. Të përgjithshme.

ANEX 1 hartohet si një material shoqërues i Formatit të Aplikimit të Projekteve të Infrastrukturës për të dhënë disa sqarime dhe për të lehtësuar institucionet në plotësimin e aplikimeve të propozimeve për projektet përkatëse. Kjo bëhet në mbështetje edhe të Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për periudhën 2016-2020 dhe për të rritur kapacitetin dhe nivelin e studiuesve dhe kërkuesve për të ndërmarrë projekte kërkimore të klasit të lartë me synimin e zhvillimit dhe aplikimit të metodave dhe teknologjive inovative. Agjencia e Kërkimit Teknologjik dhe Inovacionit (AKTI) ofron fonde financiare për blerjen e infrastrukturës kërkimore-shkencore nëpërmjet aplikimit të projekteve.

Infrastruktura kërkimore-shkencore i shërben studiuesve dhe kërkuesve për të nxitur dhe për të realizuar synimet dhe objektivat e projekteve të tyre të gjeneruara edhe nga bashkëpunimi i ngushtë midis sektorëve akademike, publike dhe nevojave të ndërmarrjeve private.

Kërkimet inovative që rezultojnë nga mendjet e kualifikuara dhe infrastruktura solide do të shërbejnë shoqërisë, ekonomisë dhe mjedisit.

AKTI nëpërmjet veprimtarisë së tij informuese, trajnuese dhe financuese pozicionohet si mbështetës kryesorë i Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin.

Në këtë mënyrë AKTI inkurajon institucionet dhe kërkuesit të punojnë në bashkëpunim me partnerë akademike, publike dhe të sektorit privat në hartimin dhe zhvillimin e projekteve dhe kryerjen e kërkimeve të nivelit të lartë të cilat nuk mund të kryhen pa pjesëmarrjen e infrastrukturës. Pra këta partnerë konsiderohen në mënyrë tipike si bashkëpunëtorë në veprimtaritë e kërkimit dhe zhvillimit të teknologjisë të cilat aktivizohen domosdoshmërisht edhe nga infrastruktura e financuar, janë të interesuar dhe kanë qëllimin përfundimtar përdorimin dhe shfrytëzimin e rezultateve të këtyre aktiviteteve.

Agjencia financon në formën e granteve deri edhe në vlerën 100% të vlerës totale të kostos së paisjes, por sugjerohet, inkurajohet dhe pranohet me prioritet edhe kontributi financiar nga palë të treta të interesuara drejtpërdrejt në përmirësimin e parametrave të



produkteve të tyre ose edhe në nxjerrjen e prodhimeve të reja me anën e aplikimit të teknologjive inovative që mund të sjellë zbatimin e projektit siç janë ndërmarrjet private, si dhe nga organizata jo qeveritare që mund të përdorin rezultatet e kërkimit në përmirësimin e politikave të tyre publike.

Më poshtë po japim disa përcaktime dhe udhëzime orientuese për të sqaruar dhe për ti ardhur në ndihmë aplikantëve mbi plotësimin sa më të rregullt e të saktë të formatit të aplikimit të projekteve të infrastrukturës kërkimore – shkencore.

2. Kush mund të aplikojë me projekte të infrastrukturës:

- A.** Universitete, kolegje dhe Institucione të klasifikuara si kërkimore – shkencore.
- B.** Spitale që përfshijnë departamente që merren me kërkime-shkencore.
- C.** Institucione kërkimore jofitimprurëse.

Pra nuk mund të pranohet për financim aplikimi individual i një kërkuesi të veçantë si edhe aplikimi nga biznese private.

Një projekt infrastrukturë i pranueshëm përfshin përvetësimin apo zhvillimin e infrastrukturës kërkimore për rritjen e kapaciteteve kërkimore, duke lejuar kryerjen e kërkimit të niveleve të larta. Infrastruktura do t'i shërbejë kërkuesve dhe do të nxisë rritet prodhuese dhe bashkëpunimin midis sektorëve akademike, publik dhe private.

Institucionet e pranueshme që lejohen të aplikojnë për të marrë dhe administruar fonde nga AKTI , përkufizohen duke plotësuar dhe udhëzimet përkatëse si më poshtë:

2.1. Universitete, institucione dhe spitale me departamente kërkimore.

AKTI miraton një universitet, institucion e spital kërkimor si të pranueshëm për aplikim nëse plotëson sa më poshtë:

- Institucionet të kenë kapacitetet për të mbështetur dhe kryer kërkimin shkencor dhe trajnim.
- Kërkuesit të kenë CV të pasur, kualifikim të plotë dhe përvojë në fushën e kërkimit shkencor.
- Sigurimi i kohës së mjaftueshme, i objekteve dhe shërbimeve që mundësojnë kërkuesit të kryejnë punën e tyre.
- Të mos ketë kufizime institucionale për publikimin e rezultateve të kërkimit dhe përshkrimin e aktiviteteve kërkimore.



- Deklaratë zyrtare e politik-bërjes së institucionit në lidhje me rolin e kërkimit dhe trajnimit në institucion si dhe aftësinë dhe gatishmërinë për të administruar fonde në përputhje me kërkesat ligjore të financuesit.

2.2. Institucionet kërkimore jofitimprurëse.

AKTI miraton një institucion kërkimor jo-fitimprurës si të pranueshme nëse plotëson sa më poshtë:

- Të jetë një institucion jo-fitimprurës që nuk është një agjenci qeveritare qendrore ose lokale, që ushtron aktivitetin e saj brenda territorit të vendit dhe që ka demonstruar kapacitete për të mbështetur dhe kryer kërkime.
- Të ketë statusin jo-fitimprurëse për qëllime tatimi mbi të ardhurat, dokumentet themeluese dhe aktet nënligjore.
- Të ketë misionin e kërkimit dhe trajnimit, kapacitete dhe një staf të kualifikuar për të mbështetur dhe kryer kërkim.
- Një listë me përshkrime të detajuara të eksperiencave të mëparshme, të aktiviteteve trajnuese të organizatës dhe nivelin arsimor të individëve të trajnuar.
- Deklaratë për gatishmërinë dhe aftësinë e organizatës për të administruar fonde në përputhje me kërkesat ligjore të financuesit.

3. E drejta e pronësisë intelektuale.

- Institucioni që merr financimin për blerjen e infrastrukturës gëzon dhe të drejtën e pronësisë intelektuale.
- AKTI nuk mban ose pretendon ndonjë pronësi ose të drejta të shfrytëzimit të cilësdo pronë intelektuale që rrjedh nga projektet e infrastrukturës të financuara nga AKTI. Institucioni marrës të përcaktojë të drejtat e shfrytëzimit të secilit partner (n.q.s. ka) në përputhje me politikat e tij institucionale.

Inkurajimi i financimit të projekteve të hartuara nga institucionet e lartpërmendura do shërbejë për të tërhequr dhe për të mbajtur pranë tyre talente kërkimore në nivel të lartë, si dhe për të trajnuar brezin e ardhshëm të kërkuesve, mbështetjen e inovacionit në sektorin privat dhe krijimin e vendeve të punës të kualitetit të lartë për të rritur konkurrueshmërinë dhe forcimin e pozitës së vendit në ekonominë e sotme të dijes.

Aplikuesi i pranueshëm, i përcaktuar si institucioni fitues që merr dhe administron fondet e AKTI-it si pasojë e një propozimi të një projekti të infrastrukturës, është përgjegjës për



të siguruar që infrastruktura kërkimore është në dispozicion të ekipit kërkimor, siç identifikohet në propozim, për të plotësuar objektivat e kërkimit.

Subjekti i pranueshëm i projektit fitues inkurajohet fuqimisht që të përdorë infrastrukturën që do disponojë për zhvillimin e bashkëpunimeve me partnerët nga sektorët akademike, publike dhe private dhe të ofrojë akses në infrastrukturën kërkimore për përdoruesit nga sektori privat, kur kjo është e përshtatshme.

Infrastrukturat duhet të jenë të lokalizuara në mënyrë optimale për të lehtësuar realizimin e objektivave të kërkimit. Rrjedhimisht, infrastruktura kërkimore mund të gjendet jashtë institucionit - duke përfshirë edhe lokalet në pronësi të partnerëve publikë ose të sektorit privat, brenda vendit - nëse vendndodhja e propozuar ju shërben objektivave kërkimore. Në rastet kur infrastruktura kërkimore lokalizohet jashtë institucionit, institucioni marrës duhet të kërkojë me parë miratimin nga AKTI.

Institucioni marrës i infrastrukturës duhet ta instalojë, ta përdorë dhe ta mirëmbajë atë sipas kushteve teknike dhe udhëzimeve të dhëna nga prodhuesi i tyre dhe të ushtrojë kontroll mbi të duke marrë përsipër edhe përgjegjësinë për funksionimin normal të pajisjeve.

AKTI inkurajon përdorimin e rezultateve të kërkimit dhe teknologjive të zhvilluara për të mirën e vendit. Në veçanti, ajo inkurajon zhvillimin e partneriteteve të frytshme me organizata akademike, publike dhe të sektorit privat, pasi këto janë ndër mjetet më efektive të transferimit të njohurive.

4. Evidentimi i tipit të projektit.

- 4.1. **Institucional** kur projekti me infrastrukturën e kërkuar vihet në përdorim dhe i shërben nevojave kërkimore të institucionit (kryesisht universitete) brenda një fushe të caktuar por që mund të përdoret edhe në mësimdhënie.
- 4.2. **Rajonal** kur projekti me infrastrukturën e kërkuar vihet në përdorim nga institucioni aplikues për nevojat kërkimore por që i shërben jo vetëm atij por edhe institucioneve të tjera rajonale si dhe qendrave dhe ndërmarrjeve sipas fushës përkatëse. (këtu favorizohen edhe Qendrat e Transferimit të Teknologjive të Bujqësisë).
- 4.3. **Kombëtar** kur projekti me infrastrukturën e kërkuar vihet në përdorim nga institucioni aplikues për nevojat kërkimore por që i shërben jo vetëm atij por edhe institucioneve të tjera si dhe komunitetit në përgjithësi në rang kombëtar. (këtu favorizohen sidomos Qendrat Spitalore Universitare dhe Institucionet që



merren me përkujdesjen, mbrojtjen dhe sigurimin e ushqimit e të shëndetit publik, për kafshët e bimët , për mjedisin, ujërat etj.

5. Objektivat.

Konceptimi i objektivave është një çështje shumë e rëndësishme. Ato duhet të jenë të qarta, realiste dhe arritja e tyre të jetë e matshme (në projekt-propozim) për arsye se progresi i projektit do të vlerësohet edhe kundrejt këtyre pikësnyimeve. Fokusimi i objektivave duhet të jetë në shfrytëzimin sa më efikas të rezultateve pas përfundimit të kërkimit si nga komuniteti shkencor por edhe më gjerë në sferën prodhuese e atë shoqërore.

6. Shpenzimet për projektin e infrastrukturës.

6.1. Institucioni aplikues duhet të vendosë në formatin e aplikimit koston e plotë të pajisjeve të infrastrukturës me çmimin aktual duke përfshirë edhe taksat si TVSH. Në përcaktimin e koston së plotë të merren parasysh dhe të përfshihen vetëm shpenzimet e pranueshme, duke përfshirë shpenzimet jo të pranueshme sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- **Shpenzime të pranueshme janë:**

- a. Dogana, transporti, akcizat dhe instalimi i pajisjeve të infrastrukturës sipas tarifave përkatëse.
- b. Komponentët dhe materialet e nevojshme për vënien në punë dhe funksionimin normal të pajisjeve.
- c. Garanci dhe kontrata shërbimi të blera në të njëjtën kohë me infrastrukturën kërkimore.
- d. Pajisje laboratorike.
- e. Liçenca programesh (software)
- f. Trajnimi fillestar për operatorin(ët) kryesor të infrastrukturës kërkimore. Një sesion trajnimi fillestar në grup mund të kërkohet të ofrohet nga shitësi në institucion.

- **Shpenzime jo të pranueshme janë:**

- a. Blerja ose marrja me qera e pronave të patundshme për vendosjen e pajisjeve të infrastrukturës që kërkohet.



- b. Kostot operative që lidhen me mirëmbajtjen e përgjithshme si zhvendosje të aparaturave ekzistuese në hapësirat në të cilat do të vendoset infrastruktura kërkimore e blerë.
- c. Furnizimet me artikuj e materiale konsumi me të cilat punon pajisja.
- d. Pagat e kërkuesve, operatorëve dhe personelit që do e përdorin.
- e. Kosto administrative të ndryshme si dhe udhëtime për konferenca.

7. Disa kritere mbi vlerësimin.

Vlerësimi i projekteve të aplikuara bëhet nga komisione të ndryshme me ekspertë të njohur në fushat e tyre profesionale. Çdo komision përbëhet nga pesë anëtarë të fushave përkatëse dhe që nuk janë pjesë e organikës së AKTI-it.

Më poshtë jepen disa kritere bazë për vlerësimin e projekteve të aplikuara.

7.1. Cilësia e kërkimit ku përfshihet:

- Cilësia e kërkimit shkencor.
- Cilësia e kërkuesve në grupin e projektit.
- Nevoja për infrastrukturën që porositet.

4.2. Forcimi i kapaciteteve për inovacion:

- Angazhimi institucional.
- Plani i Menaxhimit.
- Plani operativ dhe i mirëmbajtjes.
- Trajnimi i personelit të kualifikuar.
- Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe bizneseve të interesuara.

4.3. Përfitimet për vendin:

- Të shpjegohet pse kjo infrastrukturë është e përshtatshme për kërkimin e propozuar dhe pse kërkimi nuk mund të mbështetet në infrastrukturën ekzistuese.
- Çfarë është e veçantë ose unike në lidhje me mënyrën se si ju do të përdorni infrastrukturën.



- Mundësia që edhe përdorues të tjerë (përveç aplikantëve të grupit) mund të përdorin infrastrukturën, programi i kërkimit i propozuar duhet të justifikojë blerjen e infrastrukturës së propozuar.
- Infrastruktura e kërkuar duhet të krijojë ose të pasurojë një mjedis që të nxisi tërheqjen e specialistëve dhe trajnuesve me cilësi të lartë.
- Ky mjedis do të ndihmojë që talentet e rinj të bëhen personel kërkimor cilësor dhe të përgatiten në mënyrë të mjaftueshme për karriere në fushën e kërkimit shkencor ose në sektorë të tjerë.

Financimi dhe zbatimi i projektit monitorohet nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI).